



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:193535

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05708936

C.nr.3314/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtare Dora Bajrami, me bashkëpunëtoren profesionale S.F. në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.S. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën e përfaqëson e autorizuar V.I.Xh. me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 520.33 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 20.05.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit G.S. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit ti kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:
 1. Për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2019, në shumën prej 45.46 euro;
 2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;
 3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro;
 4. Për periudhën kohore Janar – 30.06.2022, në shumën prej 293.01 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 520.33 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (21.09.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

Arsyetim

Paditësi G.S. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit i përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 21.09.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit- Prizren, me objekt të kontestit për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar, se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU “Mustafa Baku” në Prizren, me kontratë pune në kohë të pacaktuar. Tutje, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 07.12.2023 ka kërkuar që paditësit ti njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 30.06.2022 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2019 në 2.7 %, për vitin 2020 në 0.2 %, për vitin 2021 në 3.4 % dhe për vitin 2022 në 11.6 %, në pagën e kërkuar prej 444.79 euro e në shumë të përgjithshme prej 645.82. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për precizimin e padisë shumë prej 104 euro dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 228.00 euro.

Po ashtu me parashtrësën e datës 12.04.2024 i autorizuari i paditësit sërish ka kërkuar që paditësit ti njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 30.06.2022, dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2019 në 2.7 %, për vitin 2020 në 0.2 %, për vitin 2021 në 3.4 % dhe për vitin 2022 në 11.06 %, në pagën e kërkuar prej 421 euro e në shumë të përgjithshme prej 520.33. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 29.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendonë paditësi nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe

organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së, saktësisht për vitin 2019 e deri me paraqitjen e padisë në gjykatë. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me numër protokolli 42/2019 e datës 01.09.2019 e lëshuar në emër të paditësit nga këtu e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura SHFMU “Mustafa Baku” në Prizren, si arsimtar i artit figurativë.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019, 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet se paga bazë e paditësit ka qenë në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me date 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.09.2019 deri me datë 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësin në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 45.46 euro ($421 * 2.7\% = 11.36 * 4 \text{ muaj} = 45.46 \text{ euro}$).

- Për periudhën 01.01.2020 deri me datë 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësin në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($421 * 0.2 \% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me datë 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësin në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me datë 30.06.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 293.01 euro ($421 * 11.6 \% = 48.83 * 6 \text{ muaj} = 293.01 \text{ euro}$), apo
- Në shumën e përgjithshme prej 520.33 euro e llogaritur për 4 vite (01.09.2019, 2020, 2021, 30.06.2022).

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrajt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Gjykata konstaton se me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 21.09.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.09.2019 e deri më 30.06.2022, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 21.09.2022 gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin Shtator 2019 respektivisht nga data (01.09.2019) pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin Shtator 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e muajit Shtator 2019, e cila pagë realizohet në fund të muajit Shtator 2019 rrjedhimisht i njëjti atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin Shtator 2019 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht 01 Tetor 2019, i njëjti ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se padia e paditësit për periudhën 01.09.2019 e deri më 30.06.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit të palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më date 21.09.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit nuk iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2019 deri më datë 30.06.2022.

Gjithashtu gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimin të padisë në këtë gjykatë (21.09.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Ndërsa gjykata e gjeti si të pa bazuar kërkesën prej 104 euro në emër të precizimit të padisë pasi që është obligim I palës paditëse që padia me rastin e paraqitjes të jetë në përputhje me nenin 253 të LPK-së pra kërkesa të jete e caktuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.3314/2022 të datës 20.05.2024

Gjyqtare
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.